REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



# EKONOMIA DHE BUXHETI

*SHKURT, 2010*

# *Raporti Mujor*

## *Shkurt, 2010*

*Kontakt:*
*Telefon: ++355 (4) 228 1009*
*e-mail: elami@minfin.gov.al*

www.minfin.gov.al

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE ............................................................ 2

ZHVILLIMET EKONOMIKE ...................................................... 3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi mesatar i këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 7
7. Oferta e Parasë 8
8. Depozitat sipas Burimeve 9

SEKTORI FISKAL ....................................................................10

1. Buxheti i Konsoliduar 10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 11
3. Financimi i Bilancit Fiskal 12

ANEKSI STATISTIKOR ...........................................................12

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Shkurt, 2010 arriti në 107.9 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Shkurt ishte 4.4 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Shkurt 2010 ishte 101.34 lekë për dollarë dhe 138.80 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Shkurt shënuan kuotat 7.60 përqind për depozitat 24 mujore, 6.74 për ato 12 mujore, 5.64 për 6 mujorët dhe 4.94 perqind per depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 12.28 përqind për huatë 12 mujore dhe 13.66 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 882.4 miliardë lekë në muajin Shkurt, duke shënuar një rritje prej rreth 8.8 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për vitin 2009 rezultoi me një defiçit të përgjithshëm prej 32.01 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar 2010 rezultoi me nje suficit të përgjithshëm prej 2.3 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë muajit të parë të 2010 arritën në rreth 24.8 miliardë lekë ose rreth 99.7 përqind e planit per periudhën.
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 22.5 miliardë lekë ose rreth 92.2 përqind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Shkurt 2010 pësoi një rritje prej 1.1 përqind krahasuar me muajin Janar dhe Dhjetor '09, kur ky indeks shënonte përkatësisht 1.0 përqind dhe 1.6 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 0.7 përqind, 0.4 përqind dhe 0.9 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Shkurt u konstatua në grupin "Ushqime dhe pije joalkolike" me 2.4 përqind. Pesha specifike relativisht e lartë që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çimimeve për këtë grup të kenë efekte të lartë mbi normën e inflacionit.

Graf - 1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*
Burimi: INSTAT

Gjatë këtij muaji rënie prej -0.5 % e pësoi indeksi i cmimit te grupit "Veshje dhe këpucë".

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *2009* | 2.1 | 1.9 | 1.6 | 1.9 | 2.1 | 2.3 |
| *2010* | 4.1 | 4.4 | | | | |
| *VITI* | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| *2009* | 2.2 | 2.2 | 2.0 | 2.3 | 2.8 | 3.5 |
| *2010* | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

Norma vjetore e inflacionit në muajin Shkurt arriti në 4.4 përqind duke qëndruar jashtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2009 dhe 2010 paraqiten në tabelën 1.

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Shkurt 2010, arriti në 138.80 Lekë/Euro, duke shënuar një rritje prej 0.4 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Shkurt një euro u këmbye me 138.89 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Shkurt 2010, arriti në 101.34 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 4.6 përqind kundrejt muajit Janar. Në fund të muajit Shkurt, dollari amerikan arriti nivelin 102.15 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Shkurt të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 0.7 përqind dhe është zhvlersuar kundrejt monedhës europiane, Euro, me 7.8 përqind.

Graf - 2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Shkurt '10*

Nëncmimi dhe mbicmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 1.370 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet te politkës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

## 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Shkurt 2010, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.74 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.03 përqind në krahasim me muajin Janar ku normat e interesit shënonin vlerën 6.77 përqind. Rënie për këtë muaj kanë pësuan depozitat me afat 3-mujor dhe 1-mujor të krahasuara me muajin paraardhës, përkatesisht me 0.12 përqind dhe 0.08 përqind. Normat e interesit për depozitat me afat 6 – mujor pësuan rritje me 0.07 përqind krahasuar me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave me afat 6 dhe 3 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Shkurt pësoi një rritje me 0.04 pikë përqind, duke arritur në 12.28 përqind nga 12.24 përqind që ishte në muajin Janar. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 1.29 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Shkurt arriti në 13.66 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Shkurt 2009, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor ishin përkatësisht 8.88 përqind, 7.46 përqind dhe 6.27 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për afatet 12 dhe 6 – mujore të maturimit.

Graf - 3




*Normat e interesit për depozitat*

Graf - 4




*Normat e interesit për huatë*

# 4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




*Bilanci i Pagesave*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Shkurt – Shkurt 2009 regjistroi nje defiçit të përgjithshëm prej 32.01 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6




*Llogaria Korente*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiçitit të llogarisë korente prej 1,327 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën Shkurt'09 - Shkurt'09 rezultoi: *(i)* bilanci tregtar -2,303.7 mln euro, *(ii)* shërbime neto 120.92 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -78.69 mln euro, (iv) transferta neto 934.48 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Shkurt 2010, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 18,525.0 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2009. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 5,586.1 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 12,938.9 milionë lekë. Në muajin Shkurt sistemi bankar rezulton me një rritje prej 2,727.1 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Janar ‘10, rritje e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 1,137.4 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 3,864.5 milionë lekë.

Graf - 7




*Ecuria e M.V.N. te sistemit në Shk '09-Shk '10*

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Shkurt 2010 arriti në 446.9 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me muajin Janar shënoi vlerën 2.1 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 0.5 përqind. Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 68.2 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 304.6 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 32.8 përqind.

# 7. Oferta e Parasë

Graf - 8




*Agregati M3 Shk '09- Shk '10*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Shkurt ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Janar. Kjo ofertë arriti në rreth 882 miliardë lekë në fund të muajit Shkurt duke shënuar një rritje prej 2.3 miliardë lekë kundrejt nivelit të rregjistruar në muajin Janar. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 8.8 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar.

Graf - 10




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 3.9 miliardë lekë në krahasim me muajin Janar.

Graf - 11




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Shkurt, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 82.0 përqind të depozitave totale në valutë.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Shkurt 2010 “sektorë të tjerë rezident”, zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 52.1 përqind, ndjekur nga “korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 31.0 përqind dhe nga “korporata publike jofinanciare”, me 14.4 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” dhe “korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 82.0 përqind dhe rreth 14.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezident” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i Depozitave të tjera në lekë (94.8 përqind e totalit)

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezident” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 586 miliarde) të depozitave totale, prej rreth 684 miliardë lekë në muajin Shkurt 2010. Ata ndiqen nga “korporata të tjera jofinanciare” (73.8 miliardë), “korporatat të tjera financiare publike” (18.3 miliardë) dhe “korporata jofinanciare publike” (5.5 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 0.9 miliardë në totalin e depozitave.

Graf - 12




***Përberja e depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit Shkurt 2010, krahasuar me nje muaj më parë Janar niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 3.9 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në lekë dhe atyre në valutë .

# SEKTORI FISKAL

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin Janar 2010 janë mbledhur rreth 24.8 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 22.5 miliardë lekë, që përfshijne 18.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 4.3 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 90.4 % financim i brendshëm, dhe 9.6 % financim i huaj.

Graf - 13




*Treguesit Fiskal, Janar 2010*

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 6.9 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2010, ndërsa shpenzimet përbëjnë 5.5 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 5.7 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 4.9 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 15.6 miliardë lekë (ose rreth 6.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 1.1 miliarde lekë (5.2 % e të ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerorë dhe shëndetesore 5.1 miliarde lekë (8.2 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 3 miliardë lekë (12.3 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korente prej 18.3 miliarde lekë, 5.3 miliardë lekë (23.7 % e totalit të shpenzimeve korente) është shpenzuar për personelin, 2.1 miliardë lekë (11.6 %) për interesat, 1.3 miliardë lekë (7 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.7 miliardë lekë (0.04 %) për subvencione, 7.1 miliardë lekë (39.1%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore dhe 1.2 miliardë lekë (6.5 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 1.2 miliardë lekë (6.5 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 7.9 % (shpenzime personeli), 4.9 % (shpenzime për interesat), 3.4 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 0.4 % (subvencione), 6.5 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 3.1 % dhe 5.8 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 6.5 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 1.5 %.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar 2010 ishin rreth 24.8 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 21.7 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 3 miliardë

Tab - 2 *Të ardhurat e realizuara në Janar 2010*

| Burimi | Miliardë Lekë |
|---|---|
| TVSH | 8.2 |
| Tatimi mbi fitimin | 1.1 |
| Taksa doganore | 0.4 |
| Taksat nacionale | 1.2 |
| Akcizat | 2.3 |

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Sufiçiti prej 2.3 miliardë lekë, për periudhën Janar 2010, u mbeshtet në vlerën 2.3 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 21 milionë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Janar disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 24.8 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve ne masën 21.7 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhe kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 15.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 18.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 4.3 miliarde lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | Month |
| Janar | 0.2 | 0.5 | 0.5 | 0.4 | 1.0 | 0.20 | 0.50 | 0.50 | 0.40 | 1.00 | 1.4 | 2.9 | 3.0 | 2.1 | 4.1 | January |
| Shkurt | 0.4 | 0.5 | 1.0 | 0.7 | 1.1 | 0.30 | 0.50 | 0.75 | 0.55 | 1.05 | 1.3 | 2.9 | 3.6 | 1.9 | 4.4 | February |
| Mars | 0.1 | -0.1 | 0.9 | 0.6 | | 0.23 | 0.30 | 0.80 | 0.57 | | 1.5 | 2.7 | 4.6 | 1.6 | | March |
| Prill | 0.6 | -0.2 | -0.4 | -0.1 | | 0.33 | 0.18 | 0.50 | 0.40 | | 2.4 | 1.9 | 4.4 | 1.9 | | April |
| Maj | -0.4 | -0.8 | -1.0 | -0.8 | | 0.18 | -0.02 | 0.20 | 0.16 | | 3.1 | 1.4 | 4.2 | 2.1 | | May |
| Qershor | -1.1 | -0.6 | -0.8 | -0.6 | | -0.03 | -0.12 | 0.03 | 0.03 | | 2.4 | 2.0 | 4.0 | 2.3 | | June |
| Korik | -0.4 | -0.3 | -0.6 | -0.7 | | -0.09 | -0.14 | -0.06 | -0.07 | | 3.2 | 2.1 | 3.7 | 2.2 | | July |
| Gusht | -0.2 | 1.9 | 0.6 | 0.7 | | -0.10 | 0.11 | 0.03 | 0.03 | | 2.8 | 4.2 | 2.5 | 2.2 | | August |
| Shtator | 0.6 | 0.9 | 1.1 | 0.8 | | -0.02 | 0.20 | 0.14 | 0.11 | | 2.6 | 4.4 | 2.7 | 2.0 | | September |
| Tetor | 0.1 | -0.1 | 0.1 | 0.4 | | -0.01 | 0.17 | 0.14 | 0.14 | | 2.2 | 4.2 | 2.8 | 2.3 | | October |
| Nendor | 0.9 | 0.2 | -0.1 | 0.4 | | 0.07 | 0.17 | 0.12 | 0.16 | | 2.9 | 3.5 | 2.6 | 2.8 | | November |
| Dhjetor | 1.8 | 1.3 | 0.9 | 1.6 | | 0.22 | 0.27 | 0.18 | 0.28 | | 2.5 | 3.1 | 2.2 | 3.5 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i kembimit**

Exchange rate

ɘdhes se huaj *(Leke per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Jan | 2010 Feb | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhes* | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 98.10 | 90.43 | 83.89 | 94.98 | 96.84 | 101.34 | USD |
| EURO | 123.08 | 123.63 | 122.80 | 132.06 | 138.28 | 138.80 | EURO |
| *Fundi i periudhes* | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 93.67 | 82.89 | 87.91 | 95.81 | 99.60 | 102.15 | USD |
| EURO | 123.70 | 121.78 | 123.80 | 137.96 | 139.08 | 138.89 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3

**Normat e interesit me baze vjetore**

Annual Interest Rates

| | | | | 2010 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ne perqindje<br>Fundi I periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | Janar<br>Jan | **Shkurt**<br>**Feb** | In percent<br>End of period |
| **Norma e remunerimit** | | | | | | **Remuneration rate** |
| ne leke | 4.37 | 4.37 | 3.67 | 3.67 | 3.67 | In Lek |
| ne usd | 3.40 | 0.70 | 0.09 | 0.09 | 0.09 | In USD |
| ne euro | 3.11 | 2.28 | 0.70 | 0.70 | 0.70 | in EURO |
| **Norma e depozitave** | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 5.67 | 6.93 | 6.78 | 6.77 | 6.74 | 12-M |
| 6-M | 4.83 | 5.72 | 5.74 | 5.57 | 5.64 | 6-M |
| 3-M | 4.12 | 5.13 | 5.05 | 5.06 | 4.94 | 3-M |
| 1-M | 3.83 | 4.30 | 4.56 | 4.48 | 4.40 | 1-M |
| **Norma e huase** | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 11.73 | 11.75 | 12.46 | 12.24 | 12.28 | 12-M |
| 6-M | 14.11 | 12.85 | 12.54 | 12.37 | 13.66 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlere** | | | | | | **Securities rates** |
| Bobo thesari 1/ | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.48 | 6.27 | 6.30 | _ | 6.27 | 3-M |
| 6-M | 7.51 | 7.45 | 7.52 | 7.48 | 7.46 | 6-M |
| 12-M | 8.41 | 8.56 | 9.14 | 8.99 | 8.88 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4 **TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2010**
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2009

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke (in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Janar Jan | ITEM | No. |
|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TE ARDHURAVE** | **24,832** | **TOTAL REVENUE** | |
| I. | **Ndihma** | **89** | **Grants** | I. |
| II. | **Te ardhura tatimore** | **21,730** | **Tax Revenue** | II. |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **15,566** | **From tax offices and customs** | II.1 |
| 1 | Tatimi mbi Vleren e Shtuar | 8,231 | V. A. T | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,051 | Profit Tax | 2 |
| 3 | Akcizat | 2,305 | Excise Tax | 3 |
| 4 | Tatimi mbi te Ardhurat Personale | 2,391 | Personal Income Tax | 4 |
| 5 | Taksa Nacionale dhe te tjera | 1,151 | National Taxes and others | 5 |
| 6 | Taksa Doganore | 437 | Custom Duties | 6 |
| II.2 | **Te ardhura nga Pushteti Lokal** | **1,083** | **Revenues from Local Gov.** | II.2 |
| 1 | Tatimi mbi pasurine | 81 | Tax on land | 1 |
| 2 | Tatimi mbi Biznesin e vogel | 328 | Small Business Tax | 2 |
| 3 | Taksa lokale | 674 | Local Taxes | 3 |
| II.3 | **Te ardh Buxh. Pavarur** | **5,081** | **Social ins** | II.3 |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 4,410 | Social Insurance | 1 |
| 2 | Sigurimi Shendetsor | 671 | Health insurance | 2 |
| III. | **Te ardhura Jotatimore** | **3,014** | **Nontax Revenue** | III. |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise | 0 | Profit transfer from BOA | 1 |
| 2 | Te ardhura nga Inst.Buxhetore | 2,532 | Income of budgetary institutions | 2 |
| 3 | Dividenti | 8 | Divident fines | 3 |
| 4 | Tarifa sherbimesh | 346 | Services | 4 |
| 5 | Te tjera dhe interesa | 128 | Other/not allocated | 5 |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **22,530** | **TOTAL EXPENDITURE** | I. |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **18,253** | **Current Expenditures** | I.1 |
| I.1 | **Personeli** | **5,348** | **Personnel expenditures** | 1 |
| 1 | Paga | 4,586 | Wages | 2 |
| 2 | Kontributi per Sigurime Shoqerore | 761 | Social insurance contributions | 3 |
| 3 | Politikat e reja pagash | | Of which; Contingency | |
| I.2 | **Interesat** | **2,120** | **Interest** | I.2 |
| 1 | Te Brendshme | 1,982 | Domestic | 1 |
| 2 | Te Huaja | 138 | Foreign | 2 |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirembajtje** | **1,269** | **Operational & Maintenance** | I.3 |
| I.4 | **Subvencionet** | **7** | **Subsidies** | I.4 |
| | **Mbeshtetje per Energjine** | | | I.5 |
| I.5 | **Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera** | **7,130** | **Social insurance outlays** | 1.5 |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 5,789 | Social insurance | 1 |
| 2 | Sigurime Shendetsore | 1,340 | Health insurance | 2 |
| I.6 | **Shpenzime per Buxhetin Lokal** | **1,195** | **Local Budget** | I.6 |
| I.7 | **Shpenzime te tjera** | **1,186** | **Other expenditures** | I.7 |
| 1 | Pagesa e Papunesise | 78 | Unemployment insurance benefits | 1 |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 1,108 | Social assistance | 2 |
| 3 | Kompensim per ish te perndjekurit politike | | Compensation for ex political prisoners | 3 |
| I.8 | **Kompensim ne vlere i pronareve** | | **Property Compensation** | I.8 |
| II. | **Fondi Rezerve** | | **Reserve fund/contigency** | II. |
| III. | **Shpenzime Kapitale** | **4,277** | **Capital expenditures** | III. |
| 1 | Financimi Brendshem | 3,867 | Domestically financing | 1 |
| 2 | Financimi Huaj | 410 | Foreign financed | 2 |
| | **DEFIÇITI** | **2,302** | **Deficit** | |
| | **FINANCIMI DEFIÇITIT** | **-2,302** | **Deficit Financing** | |
| | Brendshem | -2,282 | Domestic | |
| | Te ardhura nga privatizimi | 2 | Privatization receipts | |
| | Hua-marrje e brendeshme | 5,033 | Domestic Borrowing | |
| | Huadhenie (blerje aksionesh) | | | |
| | Te tjera | -7,317 | Other | |
| | I Huaj | -21 | Foreign | |
| | Hua afatgjate(e marre) nga e cila: | 549 | Long-term Loan(Drawings) | |
| | Ndryshimi i gjendjes se arkes* | -207 | Chang. of stat. Account* | |
| | Ripagesat | -362 | Repayments | |
| | | | | |
| | KAPITUJT KRYESORE | | **Main indicators** | |
| | Financimi i Brendshem i Defiçitit | -2,282 | Domestically financed deficit | |
| | Defiçiti Pergjithshem | 2,302 | Overall Balance | |
| | Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend. | -2,048 | Soc.& health insur.contr.-outlays | |

* *"Ndryshimi i gjendjes se arkes" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja*
*"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit*

*Te dhena operative* *preliminary data*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2010**

Table of investments 2010

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>Jan | |
|---|---|---|
| Financim i brendshem | 3,867 | Domestic financing |
| *Ne %* | *90.42%* | *In %* |
| Financim i huaj | 410 | Foreign financing |
| *Ne %* | *9.58%* | *In %* |
| Totali | 4,277 | Total |
| *Ne %* | *100.00%* | *In %* |

Tab - 6

**TE ARDHURAT NGA ZYRAT E DOGANAVE 2010**

**REVENUES FROM CUSTOMS OFFICE 2010**

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| | Janar<br>Jan | |
|---|---|---|
| Takse doganore | 437 | Customs Duties |
| TVSH | 5,270 | V.A.T |
| Akcize | 1,351 | Excises |
| Te tjera | 61 | Others |
| TOTALI I DOGANAVE | 7,119 | Total from customs office |
| **TE ARDHURAT TATIMORE NGA ZYRAT E TATIMEVE DHE INSTITUCIONET BUXHETORE** | | |
| **TAX REVENUES FROM TAX OFFICE AND OTHER INSTITUTIONS** | | |
| TVSH | 2,961 | V.A.T |
| Akciza | 955 | Excises |
| Tatimi mbi fitimin | 1,051 | Profit Tax |
| Tatimi mbi te ardhurat personale | 2,391 | Personal income tax |
| Takse nacionale | 1,090 | National taxes |
| TOTALI I TATIMEVE | 8,447 | Total from tax office |
| **TOTALI** | **15,566** | **Total** |

*Burimi : Ministria e Financave* *Source : Ministry of Finance*

Tab - 7 **TE ARDHURAT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK 2010**
Revenues by economic classification 2009

*Te dhena progresive (Progresive Data)* *ne milion leke( in million leks)*

| Nr. | E M E R T I M I | Jan<br>Jan | ITEM | No. |
|---|---|---|---|---|
| | Totali i te Ardhurave | **24,832** | Total REVENUE | |
| A. | **BUXHETI QENDROR** | **24,354** | **Central budget** | A. |
| I. | **Ndihma** | **89** | **Grants** | I. |
| II | **Te ardhura nga Sigurimet Shoqerore** | **4,598** | | II |
| III. | **Te ardhura tatimore** | **16,451** | **Tax revenues** | III. |
| 1 | Tatim fitimi, te ardhurash | 1,379 | Profit, income tax | 1 |
| 1.1 | Tatim fitimi | 1,051 | Profit Tax | 1.1 |
| 1.2 | Tatim mbi biznesin e vogel | 328 | Small business tax | 1.2 |
| 2. | Tatim mbi te ardhura personale | 2,391 | Personal income tax | 2. |
| 3. | Tatim mbi mallrat dhe sherb. e brendshme | 11,824 | Goods & services taxes | 3. |
| 3.1 | TVSH | 8,231 | V.A.T & Turnover tax | 3.1 |
| 3.2 | Akciza | 2,305 | Excises | 3.2 |
| 3.3 | Taksa e rregjistrimit te automjeteve | 79 | Tax on vehicles registration | 3.3 |
| 3.4 | Taksa nacionale | 730 | National taxes | 3.4 |
| 3.5 | Taksa lokale | 478 | Local Taxes | 3.5 |
| 4. | Tatime mbi tregtine dhe trans.nderkomb. | 498 | Trade & international transport taxes | 4. |
| 4.1 | Taksa doganore | 437 | Customs duties | 4.1 |
| 4.2 | Taksa nacionale | 61 | National taxes | 4.2 |
| 5. | Te tjera | 360 | Others | 5. |
| 5.1 | Taksa nacionale | 360 | National taxes | 5.1 |
| 5.2 | Taksa lokale | 0 | Local Taxes | 5.2 |
| IV | **Te ardhura jotatimore** | **3,216** | **Nontax Revenue** | IV |
| 1. | Te ardhura nga nd/jet dhe pronesia | 73 | Entrepreneurial and Property Income | 1. |
| 1.1 | Transferim fitimi nga Banka e Shqiperise | 0 | Profit transfer from BOA | 1.1 |
| 1.2 | Veprimt. Ekonom. e sektorit buxhetor | 7 | Income of budgetary institutions | 1.2 |
| 1.3 | Dividentet | 8 | Dividents | 1.3 |
| 1.4 | Interesa | 57 | Interests | 1.4 |
| 1.5 | Te tjera | 2 | Others | 1.5 |
| 2. | Sherbime administ. dhe te ardhura jo-indust. | 3,069 | Administrative services and non-indus receipts | 2. |
| 2.1 | Nacionale | 346 | National | 2.1 |
| 2.2 | Lokale | 198 | Local | 2.2 |
| 2.3 | Jo-industriale dhe incidentale (sekondare) | 2,526 | Non-industrial and incidental | 2.3 |
| 3. | Gjoba dhe sekuestrime | 73 | Penalties | 3. |
| 4. | Te ardhura kapitale | 1 | Capital Revenues | 4. |
| | | | | |
| B. | **Sigurime Shoqerore** | **479** | **Social insurance** | B. |
| 1 | Kontributi i Sigurimeve Shoqerore | 412 | Contribution of social insurance | 1 |
| 2 | Kontributi i ISKSH | 37 | Contribution of the institution of health caring | 2 |
| 3 | Te tjera | 30 | Others | 3 |

Tab - 8

**DEFICITI DHE FINANCIMI PER 2010**

The Deficit and Its Financing for 2010

*Te dhena progresive (Progresive Data)* — *Ne milion leke (In million Leks)*

| | Jan<br>Jan | |
|---|---|---|
| **Totali i te Ardhurave** | **24,832** | **Total Revenues** |
| **Totali i Shpenzimeve** | **22,530** | **Total Expenditures** |
| **Deficiti** | **2,302** | **Cash-Balance** |
| | | |
| **Financimi i deficitit** | **-2,302** | **Financing** |
| 1. I BRENDSHEM | -2,282 | Domestic |
| **a. Bono thesari** | **1,033** | **Treasury bills** |
| **b. Eurobono** | | |
| **c. Kapitalizimi I BKT** | | |
| **c. Obligacione** | **1,000** | **Bonds** |
| **d. Ndryshimi i gjendjes se arkes** | **-4,862** | **Chang.of stat. account** |
| Depozitat e qev. ne Banken e Shqip. | -4,591 | Deposit of Government in B.O.A |
| Depoz. e Sigurimit Shoq. & Shend. | -271 | Deposit of Social & Health Ins. |
| **e. Mjete ne ruajtje** | **139** | **Non-budget revenues** |
| **f. Te ardhura nga privatizimi** | **2** | **Privatization receipts** |
| **g. Te tjera detyrime** | **-2,594** | **Others** |
| **h. Blerje aksionesh** | | |
| **i. Kredia** | **3,000** | |
| 2.I JASHTEM | -21 | Foreign |
| a. Hua afatgjate | 187 | Long-term Loan |
| -Marre | 549 | Drawings |
| -Shlyer (Ripagesat) | 362 | Repayments |
| b. Ndryshimi i gjendjes se arkes | -207 | Chang.of stat. account |

Tab - 9

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

*Ne milion Euro* In millions Euro

| | viti 2008 | viti 2009 | |
|---|---|---|---|
| **Llogaria korente** | **-1,370.3** | **-1,327.0** | **Current Account.** |
| **Bilanci tregetar** | **-2,431.5** | **-2,303.7** | **Trade Balance.** |
| Eksporti I mallrave fob | 917.48 | 750.68 | Merchandise Exports. Fob |
| Importi I mallrave fob | -3,348.94 | -3,054.37 | Merchandise Imports. Fob |
| **Bilanci i sherbimeve** | **69.42** | **120.92** | **Trade Balance.** |
| Sherbimet Kredi | 1,687.76 | 1,718.46 | Services Credit |
| Sherbimet Debi | -1,618.34 | -1,597.54 | Services Debt |
| **Bilanci i te ardhurave** | **54.92** | **-78.69** | **Balance of Incomes** |
| Te ardhurat Kredi | 321.39 | 274.07 | Income Credit |
| Te ardhurat Debi | -266.47 | -352.76 | Income Debt |
| **Bilanci i transfertave** | **936.83** | **934.48** | **Balance of Transfers** |
| Transferta private | 905.44 | 907.39 | Private Unrequired Transfers |
| Transfertat shteterore | 31.39 | 27.09 | Offical Unrequired Transfers |
| **Llogaria kapitale** | **78.19** | **84.86** | **Capital Account** |
| **Llogaria financiare** | **1,502.74** | **933.36** | **Financial Account** |
| Investime direkte | 620.03 | 664.17 | Direct Investment |
| Investime portofoli | -44.51 | 14.19 | Portofolio Investment |
| Kapitale te tjera | 932.41 | 262.37 | Other Capital |
| **Gabime dhe harresa neto** | **-18.74** | **276.75** | **Net errors and omissions** |
| **Bilanci i pergjithshem** | **191.90** | **-32.01** | **Overall Balance** |
| Rezervat | -191.90 | 32.01 | Reserve Assets |
| Perdor kred & huash nga FMN | -5.19 | -7.37 | Use of Fund Credit and Loans |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*

Tab - 10 **MJETET VALUTORE NETO**
Net Foreign Assets

| Ne milione leke / Fundi i periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Janar / Jan | 2010 Shkurt / Feb | Millions of leke / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mjetet valutore neto** | **170,987.2** | **201,191.1** | **214,466.8** | **216,188.4** | **220,052.9** | **Net Foreign assets** |
| **Predendime ndaj jorezidenteve** | **186,401.6** | **215,529.3** | **236,223.3** | **238,231.0** | **242,146.4** | **Claims on non-rezidents** |
| Ari monetar dhe sdr | 163.3 | 641.8 | 7,546.1 | 7,437.5 | 7,351.4 | Monetary gold and SDR |
| Monedha dhe kartemonedha ne valute | 5.1 | 1,068.6 | 705.8 | 687.7 | 683.5 | Foreign currency holdings |
| Depozita | 45,773.8 | 64,087.6 | 54,391.6 | 56,610.0 | 65,052.3 | Deposits |
| Letra me vlere te jorezidenteve | 132,843.0 | 142,952.5 | 165,853.4 | 165,745.5 | 160,913.1 | Securities |
| Derivatet financiare | | | 10.7 | 9.0 | 11.5 | Financial derivatives |
| Llogari te tjera | 7,616.5 | 6,778.7 | 7,715.7 | 7,741.3 | 8,134.7 | Other accounts |
| **Minus: Detyrime ndaj jorezidenteve** | **15,414.5** | **14,338.2** | **21,756.6** | **22,042.6** | **22,093.5** | **Minus: Liabilities to non-residents** |
| Depozita | 7,150.5 | 6,783.7 | 7,981.6 | 7,982.5 | 7,983.1 | Deposits |
| Hua | 1,186.4 | 1,173.4 | 1,269.2 | 1,281.6 | 1,271.5 | Loans |
| Llogari te tjera | 7,077.6 | 6,381.1 | 12,505.8 | 12,778.6 | 12,838.9 | Other accounts |
| | | | | | | |
| **Mjetet e brendshme** | **60,112.5** | **85,397.1** | **105,263.2** | **95,740.1** | **93,034.8** | **Domestic Assets** |
| **Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore** | **57,457.0** | **64,073.6** | **71,369.8** | **63,906.8** | **63,583.2** | **Net Calims on Central Government** |
| Pretendimet neto ndaj qeverise qendrore | 78,268.5 | 83,428.2 | 82,289.4 | 80,206.8 | 77,155.5 | Claims on Central Government |
| Letra me vlere | 72,892.2 | 75,167.2 | 77,289.4 | 77,192.0 | 77,155.5 | Securities |
| Hua | - | 3,000.0 | - | 3,014.8 | - | Loans |
| Llogari te tjera | 5,376.3 | 5,261.0 | 5,000.0 | - | 0.0 | Other accounts |
| **Minus: Detyrime ndaj qeverise qendrore** | **20,811.4** | **19,354.6** | **10,919.7** | **16,300.0** | **13,572.3** | **Minus: Due to Central Government** |
| Depozita | 20,775.7 | 19,334.8 | 10,897.5 | 16,282.9 | 13,552.3 | Deposits |
| Hua | - | - | - | - | - | Loans |
| Llogari te tjera | 35.7 | 19.8 | 22.2 | 17.1 | 20.0 | Other accounts |
| **Pretendime ndaj korporatave te tjera depozituese** | **1,604.3** | **20,141.9** | **32,372.6** | **30,294.3** | **27,905.4** | **Claims on other depository corporations** |
| Depozita | - | - | - | | - | Deposits |
| Hua | 1,603.5 | 20,141.0 | 32,371.7 | 30,293.6 | 27,904.7 | Loans |
| Llogari te tjera | 0.8 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 0.7 | Other accounts |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera financiare | - | - | - | - | - | Claims on other financial corporations |
| Pretendime ndaj korporateve jofinanciare publike | - | - | - | - | - | Claims on public non-financial corporations |
| Pretendime ndaj korporatave te tjera jofinanciare | - | - | - | - | - | Claims on other non-financial corporations |
| Pretendime ndaj sektoreve te tjere rezidente | 1,051.1 | 1,181.6 | 1,520.9 | 1,539.1 | 1,546.2 | Claims on other resident sectors |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 11 **KREDIA PER EKONOMINE**
Credit to Economy

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010<br>Janar<br>Jan | 2010<br>**Shkurt**<br>**Feb** | Million of leks<br>End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Totali I kredise** | **293,869.3** | **396,231.0** | **440,397.4** | **444,827.4** | **446,920.8** | **Total Credit** |
| **Kredia per qeverine lokale** | **-** | **-** | **-** | **-** | **-** | **Credits to local Government** |
| Ne leke | - | - | - | - | - | in lek |
| Ne valute | - | - | - | - | - | in Foreingn Currency |
| | | | - | | | |
| **Kredia per korporatat jofinanciare publike** | **3,923.0** | **12,899.1** | **12,056.3** | **12,443.8** | **12,205.4** | **Credits to Public Non-financial Corporations** |
| Ne leke | - | 3,636.7 | 6,323.5 | 6,334.7 | 6,305.0 | in lek |
| Ne valute | 3,923.0 | 9,262.4 | 5,732.8 | 6,109.0 | 5,900.4 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat jofinanciare private** | **182,050.7** | **242,050.6** | **275,479.8** | **279,396.6** | **281,942.9** | **Credits to other Non-financial Corporations** |
| Ne leke | 35,708.4 | 49,111.0 | 70,353.3 | 70,648.6 | 72,575.6 | in lek |
| Ne valute | 146,342.2 | 192,939.7 | 205,126.5 | 208,748.1 | 209,367.4 | in Foreingn Currency |
| **Kredia per korporatat e tjera financiare** | **97.4** | **376.2** | **6,032.3** | **6,080.2** | **6,291.2** | **Credits to Other Financial Corporations** |
| Ne leke | 70.2 | 334.7 | 816.3 | 781.1 | 1,034.4 | in lek |
| Ne valute | 27.2 | 41.5 | 5,216.0 | 5,299.1 | 5,256.8 | in Foreingn Currency |
| **Pretendime per sektore te tjere rezidente** | **107,798.2** | **140,905.1** | **146,829.0** | **146,906.7** | **146,481.3** | **Claims to other Resident Sectors** |
| Ne leke | 49,059.4 | 60,936.2 | 62,986.8 | 62,473.5 | 62,373.2 | in lek |
| Ne valute | 58,738.8 | 79,968.9 | 83,842.3 | 84,433.3 | 84,108.2 | in Foreingn Currency |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 12

**OFERTA E PARASE**
Money Supply

Mujor-Monthly

| Ne milion leke / Fundi I periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Janar / Jan | 2010 Shkurt / Feb | Millions of LEK / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Baza monetare** | 228,230.9 | 271,729.2 | 284,839.7 | 276,077.2 | 274,545.2 | **Base Money** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 4.9 | 19.1 | 4.8 | 2.5 | 2.1 | Y/Y change in % |
| **Paraja jashte korporatave depozituese** | 154,956.2 | 195,808.5 | 209,043.8 | 199,124.9 | 197,420.2 | **Currency Outside Depository** |
| Ndryshimi vjetor ne % | -5.1 | 26.4 | 6.8 | 1.3 | -1.4 | Y/Y change in % |
| **Rezervat e bankave** | 67,035.6 | 67,793.3 | 68,071.5 | 68,297.4 | 68,617.5 | **Bank's Reserves** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 35.8 | 1.1 | 0.4 | 6.2 | 11.9 | Y/Y change in % |
| **Depozita** | 602,653.7 | 619,790.4 | 662,425.7 | 681,023.9 | 684,979.9 | **Deposits** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 19.8 | 2.8 | 6.9 | 9.8 | 12.2 | Y/Y change in % |
| **Agregati M1** | 242,676.0 | 282,853.5 | 284,505.6 | 269,418.6 | 266,596.1 | **M1 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 0.1 | 16.6 | 0.6 | -2.2 | -2.1 | Y/Y change in % |
| **Agregati M2** | 506,137.5 | 554,908.7 | 578,181.5 | 571,515.5 | 573,089.0 | **M2 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 6.0 | 9.6 | 4.2 | 3.9 | 4.8 | Y/Y change in % |
| **Agregati M3** | 757,609.9 | 815,598.9 | 871,469.5 | 880,148.8 | 882,400.1 | **M3 Aggregate** |
| Ndryshimi vjetor ne % | 13.7 | 7.7 | 6.8 | 7.8 | 8.8 | Y/Y change in % |
| **Burimet e bazes monetare** | | | | | | **Bonetary Base sources** |
| Mjetet e huaja neto | 170,987.2 | 201,191.1 | 214,466.8 | 216,188.4 | 220,052.9 | Net foreign assets |
| Mjetet e brendshme neto | 60,112.5 | 85,397.1 | 105,263.2 | 95,740.1 | 93,034.8 | Domestic assets |
| Pretendimet ndaj qeverise qendrore neto | 57,457.0 | 64,073.6 | 71,369.8 | 63,906.8 | 63,583.2 | Net Claims on central government |
| Pretendimet ndaj korporatave te tjera depozituese | 1,604.3 | 20,141.9 | 32,372.6 | 30,294.3 | 27,905.4 | Clains on other depository corporatons |
| Te tjera neto | -481.4 | 14,859.0 | 34,890.3 | 35,851.3 | 38,542.6 | Remaining items net |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 13 **DEPOZITAT**
Deposits

| Ne milione leke / Fundi i periudhes | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 Janar / Jan | 2010 Shkurt / Feb | Millions of Leks / End of Period |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Në lekë** | **351,181.0** | **359,187.4** | **369,137.8** | **372,390.6** | **375,668.7** | **In national currency** |
| **Depozitat e transferueshme** | **69,461.8** | **70,355.2** | **61,372.0** | **56,784.8** | **55,943.3** | **Transferable deposits** |
| Qeveria lokale | 478.7 | 482.8 | 478.1 | 573.6 | 580.8 | Local governments |
| Korporata të tjera financiare | 11,459.8 | 698.2 | 7,687.7 | 7,779.4 | 8,047.9 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | 557.2 | 6,768.7 | 675.3 | 747.3 | 794.3 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 31,857.1 | 33,320.4 | 20,574.7 | 18,404.2 | 17,354.9 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 25,108.9 | 29,085.2 | 31,956.3 | 29,280.2 | 29,165.4 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Depozita me likuiditet të lartë (depozita pa afat)** | **18,258** | **16,690** | **14,090** | **13,509** | **13,233** | **Liquid deposits (Sight deposits)** |
| Qeveria lokale | - | - | - | - | - | Local governments |
| Korporata të tjera financiare | - | - | - | - | - | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | - | 465.2 | 107.9 | 143.2 | 12.3 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 14.6 | 261.7 | 304.6 | 256.5 | 287.9 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 18,242.9 | 15,963.0 | 13,677.3 | 13,109.2 | 12,932.3 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Depozita të tjera** | **263,462** | **272,142** | **293,676** | **302,097** | **306,493** | **Other deposits** |
| Qeveria lokale | 206.4 | 17.7 | 8.4 | 8.5 | 8.5 | Local governments |
| Korporata të tjera financiare | 2,476.6 | 831.8 | 3,378.4 | 3,247.3 | 3,448.9 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | 300.4 | 1,331.5 | 786.6 | 1,205.7 | 1,356.6 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 5,777.1 | 9,428.6 | 9,898.3 | 11,066.9 | 11,049.3 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 254,701.3 | 260,532.8 | 279,604.3 | 286,568.6 | 290,629.6 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Në valutë** | **251,472** | **260,700** | **293,288** | **308,633** | **309,311** | **In foreign currency** |
| Qeveria lokale | 371.5 | 279.5 | 313.0 | 322.9 | 354.5 | Local governments |
| Korporata të tjera financiare | 7,963.7 | 2,339.8 | 6,771.0 | 6,756.1 | 6,825.2 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | 1,569.3 | 8,089.6 | 3,672.8 | 3,660.4 | 3,405.6 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 45,791.4 | 45,922.9 | 39,582.9 | 45,892.0 | 45,136.3 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 195,776.5 | 204,068.1 | 242,948.4 | 252,001.9 | 253,589.7 | Other resident sectors |
| | | | | | | |
| **Totali** | **601,597** | **619,107** | **661,626** | **681,024** | **684,980** | **Total** |
| Qeveria lokale | 1,057 | 780 | 799 | 905 | 944 | Local governments |
| Korporata të tjera financiare | 21,900 | 3,870 | 17,837 | 17,783 | 18,322 | Other financial corporations |
| Korporata jofinanciare publike | 2,427 | 16,655 | 5,243 | 5,757 | 5,569 | Public non-financial corporations |
| Korporata të tjera jofinanciare | 83,440 | 88,934 | 70,361 | 75,620 | 73,828 | Other non-financial corporations |
| Sektorë të tjerë rezidentë | 493,830 | 509,649 | 568,186 | 580,960 | 586,317 | Other resident sectors |

*Burimi : Banka e Shqiperise* *Source : Bank of Albania*

Tab - 14 **BILANCI I PERMBLEDHUR I BSH**
Consolidated BoA Balance sheet

| Ne milion leke<br>Fundi I periudhes | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009<br>Janar<br>Jan | Shkurt<br>Feb | Mars<br>Mar | Prill<br>Apr | Maj<br>May | Qershor<br>Jun | Korrik<br>Jul | Gusht<br>Aug | Shtator<br>Sep | Tetor<br>Oct | Nentor<br>Nov | **Dhjetor**<br>**Dec** | Millions of Lek<br>End of period |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | **224,655** | **255,481** | **260,127** | **320,273** | **324,156** | **327,027** | **326,322** | **331,112** | **333,553** | **347,296** | **348,634** | **350,439** | **353,461** | **357,114** | **351,646** | **353,588** | **ASSET** |
| **Mjete te huaja** | **153,329** | **174,587** | **182,525** | **215,529** | **223,895** | **226,438** | **215,011** | **213,987** | **220,237** | **234,012** | **234,430** | **235,556** | **240,714** | **243,509** | **236,500** | **236,223** | **Foreign assets** |
| Ari | 708 | 797 | 923 | 5,265.0 | 6,239.0 | 6,697.0 | 6,273.0 | 6,062.0 | 6,357.0 | 6,042.0 | 5,959.0 | 6,101.0 | 6,370.0 | 6,699.0 | 7,446.0 | 7,324.0 | Gold |
| Depozita lek FMN | 8,431 | 7,867 | 7,031 | 6,910.0 | 7,059.0 | 6,922.0 | 6,834.0 | 6,838.0 | 7,693.0 | 7,440.0 | 8,024.0 | 13,148.0 | 14,592.0 | 14,706.0 | 14,743.0 | 14,737.0 | Deposits with the IMF |
| Depozita ne bankat e huaja | 10,175 | 38,157 | 40,976 | 58,824.0 | 50,095.0 | 44,334.0 | 39,747.0 | 46,731.0 | 52,521.0 | 78,211.0 | 53,749.0 | 41,340.0 | 52,767.0 | 56,036.0 | 51,197.0 | 47,113.0 | Deposits with foreign banks |
| Letra me vlere | 133,464 | 117,404 | 124,096 | 132,339.0 | 146,274.0 | 154,896.0 | 148,482.0 | 140,876.0 | 140,180.0 | 126,556.0 | 154,218.0 | 161,410.0 | 154,452.0 | 153,863.0 | 150,977.0 | 154,488.0 | Securities |
| Investime te mbajtura per tregetim | | 9,636 | 8,747 | 10,614.0 | 12,570.0 | 11,884.0 | 11,621.0 | 11,264.0 | 11,737.0 | 10,949.0 | 10,861.0 | 11,912.0 | 10,894.0 | 11,012.0 | 10,946.0 | 11,365.0 | Securities held for trading investments |
| Mjete te tjera te huaja | 551 | 726 | 752 | 1,577.0 | 1,658.0 | 1,705.0 | 2,054.0 | 2,216.0 | 1,749.0 | 4,814.0 | 1,619.0 | 1,645.0 | 1,639.0 | 1,193.0 | 1,191.0 | 1,196.0 | Other foreign assets |
| **Mjete vendase** | **71,326** | **80,894** | **77,602** | **104,744** | **100,261** | **100,589** | **111,311** | **117,125** | **113,316** | **113,284** | **114,204** | **114,883** | **112,747** | **113,605** | **115,146** | **117,365** | **Domestic assets** |
| Ari dhe metale te çmuara | 50 | 53 | 63 | 2,462.0 | 2,931.0 | 3,153.0 | 2,961.0 | 2,862.0 | 3,018.0 | 2,860.0 | 2,818.0 | 2,894.0 | 3,033.0 | 3,183.0 | 3,531.0 | 3,477.0 | Other gold and precious metals |
| Kredi tranzite | 207 | 139 | 95 | 69.0 | 70.0 | 72.0 | 58.0 | 58.0 | 59.0 | 58.0 | 58.0 | 59.0 | 45.0 | 46.0 | 46.0 | 46.0 | Transit credits |
| Hua dhene bankave | 0 | 8,904 | 1,509 | 20,072.0 | 15,429.0 | 18,415.0 | 22,188.0 | 28,182.0 | 31,191.0 | 31,266.0 | 32,499.0 | 36,621.0 | 34,184.0 | 31,001.0 | 31,996.0 | 32,326.0 | Loans to the Banks |
| Hua per qeverine | 0 | 0 | 0 | 3,000.0 | 3,018.0 | 0.0 | 7,031.0 | 7,013.0 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | Loans to the Government |
| Investime ne letra me vlere | 68,546 | 67,575 | 72,432 | 74,594.0 | 74,308.0 | 74,385.0 | 74,510.0 | 74,452.0 | 74,468.0 | 74,401.0 | 74,135.0 | 70,525.0 | 70,675.0 | 74,506.0 | 74,704.0 | 76,589.0 | Investments in securities |
| Mjete te tjera ne leke | 2,523 | 4,223 | 3,503 | 4,547.0 | 4,505.0 | 4,564.0 | 4,563.0 | 4,558.0 | 4,580.0 | 4,699.0 | 4,694.0 | 4,784.0 | 4,810.0 | 4,869.0 | 4,869.0 | 4,927.0 | Other domestic assets |
| **DETYRIMET** | **224,655** | **255,481** | **260,127** | **320,273** | **324,156** | **327,027** | **326,322** | **331,112** | **333,553** | **347,296** | **348,634** | **350,439** | **353,461** | **357,114** | **351,646** | **353,588** | **LIABILITIES** |
| **Detyrime te huaja** | **17,464** | **16,688** | **15,380** | **14,308** | **15,067** | **15,211** | **14,781** | **14,736** | **16,526** | **18,735** | **15,186** | **21,337** | **21,859** | **21,608** | **21,681** | **21,731** | **Foreign liabilities** |
| Detyrime ndaj FMN-se | 16,145 | 15,256 | 13,946 | 12,869.0 | 13,423.0 | 13,409.0 | 13,183.0 | 13,213.0 | 14,144.0 | 13,850.0 | 13,510.0 | 18,709.0 | 20,157.0 | 20,336.0 | 20,399.0 | 20,452.0 | Due to the IMF |
| Detyrime ndaj institucioneve financiare jorezidente | 1,319 | 1,246 | 1,183 | 1,178.0 | 1,202.0 | 1,230.0 | 1,227.0 | 1,228.0 | 1,242.0 | 1,227.0 | 1,218.0 | 1,238.0 | 1,244.0 | 1,272.0 | 1,282.0 | 1,279.0 | Due to non-resident fin. Institutions |
| Detyrime te tjera ne valute | 0 | 186 | 251 | 261.0 | 442.0 | 572.0 | 371.0 | 295.0 | 1,140.0 | 3,658.0 | 458.0 | 1,390.0 | 458.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Other foreign liabilities |
| **Detyrime vendase** | **205,978** | **238,783** | **243,456** | **294,092** | **284,950** | **281,214** | **282,704** | **287,140** | **289,220** | **302,947** | **308,633** | **300,538** | **302,121** | **302,273** | **294,273** | **299,309** | **Domestic liabilities** |
| Para ne qarkullim | 153,550 | 168,234 | 161,162 | 203,713.0 | 204,386.0 | 207,597.0 | 209,181.0 | 210,816.0 | 210,073.0 | 215,313.0 | 217,241.0 | 217,222.0 | 210,867.0 | 208,606.0 | 208,655.0 | 216,739.0 | Currency in Circulation |
| Detyrimet ndaj bankave rezidente | 45,182 | 53,575 | 67,051 | 67,803.0 | 64,339.0 | 61,320.0 | 61,692.0 | 61,090.0 | 60,614.0 | 62,145.0 | 60,922.0 | 60,938.0 | 65,182.0 | 63,063.0 | 65,698.0 | 68,075.0 | Due to domestic banks |
| Detyrime ndaj qeverise | 6,356 | 15,944 | 14,313 | 21,096.0 | 14,491.0 | 11,347.0 | 10,704.0 | 13,542.0 | 17,541.0 | 24,456.0 | 28,457.0 | 20,814.0 | 24,488.0 | 28,819.0 | 18,643.0 | 13,355.0 | Due to Government |
| Te ardhura per tu shperndare | 129 | 76 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | | | | | | | | Distributeble Incomes |
| Detyrime te tjera ne leke | 761 | 954 | 927 | 1,480.0 | 1,734.0 | 950.0 | 1,127.0 | 1,692.0 | 992.0 | 1,033.0 | 2,013.0 | 1,564.0 | 1,584.0 | 1,785.0 | 1,277.0 | 1,140.0 | Other domestic liabilities |
| **Fondi i vet dhe rezervat** | **1,213** | **10** | **1,291** | **11,873** | **24,139** | **30,602** | **28,837** | **29,236** | **27,807** | **25,614** | **24,815** | **28,564** | **29,481** | **33,233** | **35,692** | **32,548** | **Statutory fund and reserves** |
| Fondi themelor | 750 | 750 | 2,500 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | 2,500.0 | Statutory fund and reserves |
| Rezerva ligjore | 3,750 | 3,750 | 5,181 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 7,515.0 | 9,994.0 | Legal reserve |
| Rezerva e rivleresimit | -11,469 | -15,856 | -22,759 | -15,837.0 | -4,581.0 | 903.0 | -2,051.0 | -2,793.0 | -4,033.0 | -7,017.0 | -8,518.0 | -5,525.0 | -3,825.0 | -618.0 | 1,191.0 | 2,399.0 | Revalution reserve |
| Rezerva e rivleresimit te mjeteve fikse | | 2,660 | 1,755 | 1,947.0 | 1,943.0 | 1,940.0 | 1,937.0 | 1,934.0 | 1,930.0 | 1,927.0 | 1,924.0 | 1,921.0 | 1,917.0 | 1,914.0 | 1,911.0 | 1,907.0 | |
| Rezerva te tjera | 8,182 | 8,706 | 14,614 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | 15,748.0 | Other reserve |
| Fitimi i pashperndare | 0 | 0 | … | … | 1,014.0 | 1,996.0 | 3,188.0 | 4,332.0 | 4,147.0 | 4,941.0 | 5,646.0 | 6,405.0 | 5,626.0 | 6,174.0 | 6,827.0 | … | Retained earnings |

*Burimi : BSH* *Source : Bank of Albania*